



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

VENDIM
Nr. 10, datë 10.07.2024

“Për përfaqësimin e Grupeve Parlamentare me përfaqësues/ekspertë pranë 3 Nëngrupeve të punës të ngritur në Komisionin e Posaçëm Parlamentar”

Bazuar në nenet 24 dhe vijues, të Rregullores së Kuvendit dhe në pikën VIII, paragrafi 2, të vendimit nr. 50/2024 të Kuvendit të Shqipërisë “Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian” (“Vendim nr. 50/2024”), me propozim të kryetarit, Komisioni i Posaçëm Parlamentar

VENDOSI:

1. T’u drejtohet Grupeve parlamentare të regjistruara në Kuvend, që nëse e çmojnë të arsyeshme, të propozojnë përfaqësuesit/ekspertët me të cilët dëshirojnë të përfaqësohen, për të prezantuar kontributet përkatëse, në emër të grupeve të tyre parlamentare, pranë Grupit të Ekspertëve dhe Sekretariatit Teknik, struktura të ngritura pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar, konform parashikimit të Vendimit nr. 50/2024 të Kuvendit.
2. Secili grup parlamentar mund të propozojë vetëm një përfaqësues/ekspert pranë çdonjërit prej 3 nëngrupeve të Grupit të Ekspertëve dhe 3 nëngrupeve të Sekretariatit Teknik.
3. Të autorizojë kryesinë e Komisionit për t’u komunikuar grupeve parlamentare vendimin e Kuvendit, objektin e punës së komisionit, organizimin e tij si dhe kriteret e cilësitë e domosdoshme që duhet të përmbushin përfaqësuesit/ekspertët e tyre për t’u përfshirë në këtë proces.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Fatmir XHAFAJ

Miratuar më 10.07.2024